

## ZHVILLOHET NË TUZ AKADEMIA 2 DITORE E AKTIVIZMIT ME TË RINJ NGA TIRANA, TETOVA DHE TUZI

Përgjatë datave 16-17 shkurt 2023, u organizua në Tuz (Mal i Zi), Akademia e Aktivizmit, me pjesëmarrjen e 30 vajzave nga Tirana, Tetova dhe Tuzi. Përgjatë zhvillimit të Akademisë të rinjtë, dhe kryesisht vajzat u informuan mbi rëndësinë e angazhimit në jetën sociale dhe proceset vendimmarrëse në qytetet ku jetojnë, për të ndikuar më pas në pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse, si dhe në hartimin e politikave rinore në dobi të tyre dhe bashkëmoshatarëve të tyre.

Në këtë kuadër, përgjatë ditës së 1-rë u zhvillua, pranë zyrës së organizatës mikpritëse Djeca Crne Gore në Tuz, trajnimi dhe workshop-i mbi Politikën dhe Proceset Vendimmarrëse. Gjatë trajnimit të rinjtë pjesëmarrës u njohën me konceptet bazë të angazhimit dhe pjesëmarrjes politike, si dhe më pas të ndarë në grupe pune, evidentuan nevojat dhe prioritetet kryesore për t'u adresuar në nivel lokal.

Ndërsa përgjatë ditës së 2-të u zhvillua një vizitë studimore në Komunën e Tuzit, ku të rinjtë pjesëmarrës bashkëbiseduan me Kryetarin e Kuvendit të Komunës së Tuzit Z. Fadil Kajoshaj dhe Sekretaren e Sekretariatit për Qeverisjen Lokale, Znj. Marina Ujkaj. Të rinjtë përgjatë vizitës u njohën me organogramen e Komunës së Tuzit, mënyrën e funksionimit të saj, zhvillimet që po ndodhin aktualisht, si dhe mbi angazhimin e të rinjve, vajzave dhe grave në proceset vendimmarrëse në Komunë.

Pas eksperiencës pozitive në Komunën e Tuzit, u zhvillua vizita në shkollën e mesme "25 Maji", ku u njohën më nga afër me funksionimin e kësaj shkolle, si dhe me nismat rinore që kjo shkollë ka ndërmarrë ndër vite, duke angazhuar me dhjetra të rinj dhe të reja të Komunës së Tuzit në aktivitete brenda vendit, si dhe në rajon.

Djeca Crne Gore (Tuz, Mal i Zi) dhe Lifelong Learning Network (Tetovë, Maqedoni e Veriut) janë organizata partnere në projektin "Girls - the game changers of politics", i cili zbatohet nga Instituti Shqiptar për Çështjet Publike - AIPA.

Ky projekt mbështetet nga Western Balkans Fund dhe Bashkimi Evropian, nën thirrjen për Propozime të Projekteve Rajonale, "Mbështetje për Promovimin e aktiviteteve rajonale të Shoqërisë Civile në Ballkanin Perëndimor".

Fondi i Ballkanit Perëndimor Skema Rajonale e Granteve është e bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, IPA - Instrumenti për Asistencën e Para-Aderimit.

#AlbanianInstituteofPublicAffairs

#DjecaCrneGore

#LifelongLearningNetwork

#WesternBalkansFund

#EuropeanUnion

#GirlsPower

## FOTO ILUSTRUESE

